

## OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

### PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

#### PËR ARGUMENTIMIN PËR MOS NDARJEN NË LOTE TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT

#### OBJEKTI I PROCEDURËS:

“BLERJE LËNDË DJEGËSE PËR AUTOMJETE, PËR PËRDORIM SHTËPIAK DHE  
INDUSTRIAL GLN(MISHELË)”

#### VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 56,020,663 (pesëdhjetë e gjashtë milion e njëzet mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre ) lekë pa TVSH ose 569,373.54 (pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e treqind e shtatëdhjetë e katër ) Euro pa TVSH

**Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 24.01.2025 është 98.39 (nëntëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e nëntë).**

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 ku prashikohet shprehimisht se: “*Qëllimi i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

*1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.*

*2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të*

*arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”*

Në zbatim të nenit të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote për arsyet e mëposhtme:

***Së pari-*** *Autoriteti Kontraktor e ka të pamundur teknikisht ta ndajë këtë kontratë në lote të veçantë pasi objekti i prokurimit është vetëm një zë konkretisht Lëndë djegëse GLN(Mishelë) për ngrohje dhe gatim.*

***Së dyti-*** *Autoriteti Kontraktor Përfituese, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ushtron veprimtarinë e saj e saj në Territorin e Bashkisë Tiranë si dhe në të gjitha IEVP-të të cilat janë të përqëndruara në qytete te ndryshme të Shqipërisë.*

*Nisur nga rëndësia e furnizimeve që nevojiten për sistemet e ngrohjes dhe të gatimit në IEVP-të përkatëse të cilat duhet të ndiqen në vazhdimësi dhe kohë reale për mundësimin e furnizimit në kohë dhe sipas shpërndarjes të përcaktuar nga AK-ja Përfituese është e nevojshme që furnizimet të kryhen nga një operator ekonomik pasi furnizimi do të bëhet në bazë të një grafiku shpërndarje të përcaktuar në shtojcën 7 të DT që duhet zbatuar me përpikmëri duke pasur parasysh dhe pikat ku ndodhen keto IEVP.*

*Ndryshimi i operatorëve ekonomikë që do të realizojnë objektin e kontratës gjatë zhvillimit të saj do të sillte problematika në funksionimin dhe linjën e furnizimit në kohë dhe sipas kushteve të percaktuara nga AK-të Përfituese.*

*Si përfundim,Marreveshja Kuadër me një Operator Ekonomik në këtë procedurë do të garantonte sigurinë e furnizimeve sipas kushteve të përcaktuara dhe përmbushjen e saj me sukses sipas afateve të përcaktuara nga AK-të Përfituese.*

*Mos ndarja në lote e procedurës së prokurimit, nuk e kufizon tregun, pasi kriteret e hartuara ne DST janë gjithëpërfshirëse, kriteret kualifikuese janë hartuar në mënyrë të tillë që tu jepet hapësirë dhe mundësi të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar për tu bërë pjesë e procedurës të sipërcituar.*

Për sa më lart Njësia e Prokurimit gjykon dhe argumenton se nuk ka vend për ndarjen në lotë të procedurës objekt prokurimi.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**